



DHURIMI I ORGANEVE

VENDOS. NJOFTO. PROTOKOLLO.

Vendos tani dhe plotëso kartelën e dhurimit të organeve.

Kartela e dhurimit të organeve



DHURIMI I ORGANEVE

LEBEN-IST-TEILEN.CH

*Shprehje e vullnetit për ose kundër
heqjes së organeve, indeve ose qelizave
për qëllimin e transplantimit*

TRE ARSYE TË FORTA PËR TË FOLUR RRETH DHURIMIT TË ORGANEVE.

1. Për hirin tim

Unë vendos vetë se çfarë ndodh me trupin tim, në jetë dhe përtej saj. Gjithashtu, unë vendos për këtë, nëse pas vdekjes sime dua të dhuroj ose jo organe, inde ose qeliza, po qe se do të krijohej kjo mundësi.

2. Për hirin e të afërmve të mi

Në shumicën e rasteve pyetja për dhurimin e organeve shtrohet shumë papritur. Është mirë që njerëzit e mi më të dashur e dinë vullnetin tim. Kjo i ndihmon ata të vendosin sipas dëshirës sime.

3. Për hir të jetës

Në Zvicër shumë njerëz presin për një organ të rëndësishëm për të mbijetuar. "Po"-ja ime për dhurimin mund të shpëtojë jetë një ditë.

PROTOKOLLONI VULLNETIN TUAJ

Vendosni tani nëse jepni apo jo pëlqimin tuaj për marrjen e organeve, indeve ose qelizave në rast vdekjeje. Nëse vullneti juaj është i panjohur, atëherë të afërmit tuaj më të afërt do të përballen si shtesë me këtë pyetje të vështirë në një situatë shumë ngarkuese.

Konfrontohuni me temën, vendosni dhe plotësoni kartelën e dhurimit në fund të kësaj broshure. Flisni me të afërmit tuaj për vendimin tuaj dhe i lehtësoni ata me anë të kësaj.

Informacione të mëtejshme nën:

- www.leben-ist-teilen.ch
- www.bag.admin.ch/transplantation
- www.swisstransplant.org si dhe tek mjekja juaj e familjes ose mjeku juaj i familjes.

DHURIMI MUND TË SHPËTOJË

Organet e dhurueseve dhe dhuruesve të vdekur mund t'iu transplantohen njerëzve të sëmurë rëndë. Për shembull, një transplantim i mëlçisë pas një helmimi të rëndë nga kërpudha mund të jetë shpëtimtar jete.

Edhe indet e të vdekurve mund të shpëtojnë jetë ose të paktën të përmirësojnë cilësinë e jetës së cenuar rëndë. Kështu, një valvul i zemrës mund t'i ndihmojë një fëmijë me një të metë në zemër. Një korne e syrit mund të parandalojë që dikush të verbohet.



ÇFARË MUND TË DHUROHET PAS VDEKJES?

Organet e mëposhtme mund të dhurohen pas vdekjes:

Veshkat, mushkëritë, mëlçia, zemra, pankreasi (dhe qelizat ishullore të tij) dhe zorra e hollë.

Përveç organeve, mund të dhurohen edhe inde, si kornea e syrit, valvulet e zemrës ose enët e mëdha të gjakut.

Qelizat staminale të gjakut mund të dhurohen vetëm nga persona që jetojnë. Transplantimi i këtyre qelizave shpesh është shansi i vetëm për shërim për njerëzit me leukemi dhe sëmundje të tjera të gjakut. Informacione të mëtejshme: www.blutstammzellspende.ch

KUSH MUND TË DHUROJË?

Dhurimi i organeve pas vdekjes është i mundur deri në moshë të lartë. Në rrethana të caktuara mund të dhurojnë kështu edhe të moshuarit mbi 80 vjeç. Në shumë raste merret në konsideratë një dhurim edhe atëherë, kur merren medikamente ose kur ekziston një sëmundje e mëparshme. Prandaj, në çdo rast është e dobishme të protokolloni vullnetin tuaj. Kjo është e mundur që nga moshë 16 vjeçare. Tek më të rinjtë vendosin përfaqësuesit ligjorë.

NË CILAT SITUATA?

Kushtet e përgjithshme për dhurimin e organeve pas vdekjes janë mjaft të rralla. Një dhurim merret vetëm atëherë në konsideratë, kur dikush vdes në spital në një stacion intensiv, për shembull pas një përgjakjeje masive të trurit, një dëmtimi të rëndë cerebral-kafkor ose një infarkti të rëndë në zemër. Kush vdes në shtëpi ose në një vend aksidenti nuk mund të dhurojë organe.

Indet, si për shembull kornea e syrit, mund të merren edhe nga personat që nuk kanë vdekur në spital. Kjo mund të ndodhë, varësisht nga indi, deri në 48 orë pas vdekjes. Më pas indet mund të ruhen për një periudhë të caktuar kohore deri në transplantimin.



Të dhurosh organe? E vendos ti.

LEBEN-IST-TEILEN.CH



Mushkëritë Zemra Pankreasi Veshkat Mëlçia Zorra e hollë

PROGNOZË E PASHPRESË

Pavarësisht të gjitha përpjekjeve, në stacionin intensiv nuk mund të shpëtohet çdo jetë. Në rast të një prognoze të pashpresë, trajtimet për ruajtjen e jetës duhet të përfundohen në mënyrë që pacientja ose pacienti të mund të vdesë. Vetëm trajtimet qetësuese vazhdojnë deri në vdekje. Kështu, për shembull, jepen qetësues ndaj dhimbjeve në mënyrë që personi të mos vuajë.

Vendimin, që të përfundohen trajtimet për ruajtjen e jetës, e marrin mjeket dhe mjekët së bashku me të afërmit. Vendimi merret gjithmonë pavarësisht kësaj, nëse dhurimi i organeve është i mundur apo jo.

Nëse nga ana mjekësore është i mundur dhurimi i organeve, mjeket dhe mjekët sqarojnë pastaj nëse kjo është apo jo në përputhje me vullnetin e personit që po vdes.


DHURIMI VETËM ME PËLQIM

Organet, indet dhe qelizat mund të merren pas vdekjes vetëm atëherë, nëse për këtë ekziston një miratim. Një miratim kërkohet edhe për masat e nevojshme mjekësore parapërgatitore (shih kapitullin «Masat mjekësore parapërgatitore»). Mjeket dhe mjekët i diskutojnë këto pyetje sidoqoftë me të afërmit. Gjatë kësaj vlejné rregullat e mëposhtme:

- Nëse një person ka protokolluar vullnetin e tij, për shembull në një kartë dhurimi ose në një dispozitë të pacientit, ky vullnet duhet të përmbushet.
- Nëse një person ia ka mbaruar vendimin një personi të besuar, atëherë vendos ky në vend të të afërmit.

→ Nëse nuk ka asnjë miratim ose refuzim të dokumentuar, do të pyeten të afërmit e afërt, nëse ata e dinë vullnetin. Nëse jo, ata luten të marrin një vendim. Në rast të këtij vendimi, të afërmit duhet të marrin parasysht vullnetin e supozuar të personit të prekur. Nëse të afërmit nuk janë të arritshëm ose ata nuk shprehen lidhur me këtë, është e ndaluar që të merren organe, inde ose qeliza.

Mjeket dhe mjekët lejohen të diskutojnë me të afërmit mundësinë e dhurimit të organeve vetëm pasi të jetë marrë vendimi për të ndërprerë trajtimet dhe për të lënë personin të vdesë.



PARAPËRGATITJET PËR DHURIMIN

KËRKOJNË KOHË

Nëse ekziston një miratim për dhurimin, duhet të sqarohen dhe të organizohen shumë gjëra. Do të kryhen ekzaminime të ndryshme mjekësore për të sqaruar se cilat organe janë të përshtatshme për transplantimin. Përveç kësaj, ka nevojë për analiza laboratorike të mostrave të gjakut, për të gjetur pranues dhe pranues të përshtatshëm për organet. Së fundi, duhet të organizohet heqja dhe transporti i organeve. Këto përgatitje mund të kërkojnë disa orë. Procesi në spital zgjat për këtë arsye më shumë sesa nëse personi nuk dëshiron të dhurojë.

TË MBROHEN ORGANET NGA DËMTIMI

Gjatë parapërgatitjeve për dhurimin, është e rëndësishme që organet të mos dëmtohen dhe të humbasin funksionin e tyre. Kjo kërkon masa mjekësore parapërgatitore: Personit të prekur vazhdohet t'i jepet frymëmarrje dhe ai merr medikamente, në mënyrë që të ruhet qarkullimi i gjakut dhe organet të furnizohen edhe më tej me oksigjen.



MASA MJEKËSORE

PARAPËRGATITORE

Masat mjekësore parapërgatitore janë trajtime mjekësore ndaj personit dhurues të cilat i shërbejnë mbrojtjes së organeve. Masat kryhen tanimë para vdekjes dhe më pas deri në heqjen e organeve. Varësisht nga situata janë të nevojshme masat e mëposhtme:

- Dhënia e frymëmarrjes artificiale do të vazhdojë.
- Do të stabilizohen me medikamente qarkullimi i gjakut dhe mjedisi i brendshëm i trupit.
- Merren prova të ndryshme për të mbikëqyrur funksionet e organeve në laborator.

Këto masa nuk kanë asnjë leverdi për personin dhurues, janë megjithatë patjetër të nevojshme në mënyrë që organet të mund të transplantohen dhe të funksionojnë siç duhet më pas.

MIRATIMI ËSHTË I NEVOJSHËM

- Kush thotë «Po» për dhurimin, duhet të jap miratimin si për heqjen e organeve ashtu edhe për masat parapërgatitore. Prandaj, «Po»-ja në kartelën e dhurimit vlen edhe për masat mjekësore parapërgatitore.
- Nëse mungon një shprehje me shkrim e vullnetit për masat përgatitore, atëherë është i nevojshëm një miratim zëvendësues i të afërmeve ose personit të besimit.

DY LLOJE

TË DHURIMIT

ECURIA E NJË DHURIMI TË ORGANEVE VARET NGA KJO, SE SI NDODH VDEKJA NË STACIONIN INTENSIV. DALLOHEN DY PROCEDURA:

NJË DËMTIM SHUMË I RËNDËDË I TRURIT ÇON NË VDEKJE:

Nëse truri i një personi të cilit i jepet frymëmarrje është shumë i dëmtuar, funksionet më të rëndësishme trupore ruhen vetëm përmes dhënies së frymëmarrjes dhe medikamenteve. Një rikthimi në jetë nuk është më i mundur.

Nëse merret në konsideratë dhurimi i organeve, kërkohen shumë sqarime dhe parapërgatitje. Në mënyrë që organet të mos

dëmtohen gjatë kësaj kohe, personit vazhdohet t'i jepet frymëmarrje dhe ai merr medikamente. Qarkullimi i gjakut dhe funksionet trupore ndryshe do të binin shpejt.

Nëse truri humbet funksionet e tij, personi vdes. Vdekja duhet të konstatohet qartë, përpara se të lejohet marrja e organeve. Ky lloj dhurimi pas një dëmtimi shumë të rëndë të trurit njihet në gjuhën specifike si "DBD" (donation after brain death).



NJË NDALIM I ZGJATUR I QARKULLIMIT TË GJAKUT ÇON NË VDEKJE:

Nëse prognoza e një personi të sëmurë rëndë ose të lënduar rëndë është e pashpresë dhe terapitë e mëtejshme nuk kanë kuptim, trajtimet për ruajtjen e jetës duhet të përfundohen në mënyrë që personi të mund të vdesë.

Nëse merret në konsideratë një dhurim i organeve, kërkohen sqarime dhe parapërgatitje për heqjen dhe transplantimin e organeve. Vetëm atëherë do të përfundohen trajtimet për ruajtjen e jetës.

Pas mbarimit të trajtimit, rrahjet e zemrës ngadalësohen derisa qarkullimi i gjakut ndalet plotësisht. Një kontroll me ultratinguj i zemrës duhet ta konfirmojë këtë. Pa qarkullim të gjakut truri nuk furnizohet më me gjak. Ai humbet funksionet e tij, personi vdes. Pesë minuta pas rrahjes së fundit të zemrës duhet të konstatohet vdekja. Menjëherë pas kësaj merren organet. Ky lloj dhurimi pas ndalimit të zgjatur të qarkullimit të gjakut njihet në gjuhën specifike si "DCD" (donation after circulatory death).



KONSTATIMI I VDEKJES

Para të hiqen organet nga një person i vdekur, vdekja e tij duhet të konstatohet pa dyshim. Për këtë, dy mjekë ose mjekë me formim specifik profesional duhet të provojnë se funksionet e trurit dhe trungut të trurit kanë mbaruar (kjo quhet edhe diagnostikim i vdekjes së trurit).

Mjeket dhe mjekët që konstatojnë vdekjen nuk duhet të jenë pjesë e ekipeve mjekësore, që marrin organet ose kryejnë transplantimet.

MARRJA

Pasi vdekja të jetë konstatuar pa dyshim, personi i vdekur parapërgatitet në sallën e operacionit për marrjen [e organeve]. Organet merren pastaj në një operacion prej disa orësh. Ato dërgohen sa më shpejt të jetë e mundur në spitalet, ku pranueset dhe pranuesit janë tashmë të përgatitur për transplantimet.

Nëse ekziston edhe miratimi për dhurimin e indeve, këto do të merren pas organeve.

Pas marrjes, mjeket dhe mjekët mbyllin me kujdes plagët nga operacioni dhe vendosin një fashë.

KOHA PËR LAMTUMIRËN

Të afërmit mund të jenë shumicën e kohës pranë personit dhurues, derisa të merren organet në sallën e operacionit. Koordinatore dhe koordinatorë të shkolluar në mënyrë të veçantë kujdesen për të afërmit dhe u përgjigjen në çdo kohë pyetjeve në lidhje me dhurimin dhe ecurinë.

Pas marrjes, sytë e personit të vdekur mbyllën dhe vendet e marrjes janë të mbuluara me veshje. Të afërmit tashmë mund t'i thonë lamtumirë personit të vdekur dhe të organizojnë varrimin. Ata nuk e marrin vesh se kush i ka marrë organet. Por, në rast dëshire, ata do të informohen se cilat organe mund të transplantoheshin dhe si janë marrëset dhe marrësit.



DHURIMI I ORGANEVE

VENDOS. NJOFTO. PROTOKOLLO.

Përcakto vetë, se çfarë ndodh me trupin tënd, në jetë dhe përtej saj. Prandaj, protokollo vullnetin tënd lidhur me dhurimin e organeve dhe informo edhe njerëzit e tu më të dashur për këtë.

Bëje
për hirin
tënd.

PYETJE TË SHPESHTA

1 A MERREN TË HOLLA PËR NJË DHURIM?

Ligji i transplantimit ndalon tregtinë me organe, inde ose qeliza dhe përcakton se një dhurim duhet të kryhet pa pagesë.

Dhurimi i organeve, indeve ose qelizave në çdo rast është një dhënie vullnetare dhe nuk zhëmtohet financiarisht. Të afërmve gjithashtu nuk iu krijohen asnjë pasojë financiar nga një dhurim.

2 A NDËRMERRET VËRTET GJITHÇKA PËR TË SHPËTUAR JETËN TIME, EDHE NËSE UNË KAM VENDOSUR PËR DHURIMIN E ORGANEVE?

Shpëtimi i jetëve është gjithmonë prioriteti kryesor për mjeket dhe mjekët. Vetëm kur një trajtim është i pashpresë, do të ndërpriten, pas konsultimit me të

afërmit, masat terapeutike. Ky vendim merret pavarësisht nëse dikush ka dhënë apo jo miratimin për një dhurim. Para se të merren organe, vdekja duhet të konstatohet qartë.

3 A MERREN, PAS DHËNIES SË NJË MIRATIMI, TË GJITHA ORGANET?

Merren vetëm organet që nga ana mjekësore janë të përshtatshme për një transplantim dhe për të cilat ka pranues dhe pranues të përshtatshëm. Organet, të cilat personi i prekur i ka përfshirë nga dhurimi, nuk do të merren.

4 KUSH I MERR ORGANET E DHURUARA?

Ekziston një listë pritjeje e njerëzve që kanë nevojë për një organ. Cilët persona nga kjo listë pritjeje marrin një organ, është e rregulluar saktë me ligj. Gjatë caktimit vlejné kriteret e mëposhtme: urgjenca mjekësore, leverdia mjekësore dhe koha e pritjes.

NË PAK HAPA DREJT KARTELËS VETJAKE TË DHURIMIT

1 Shënoni emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes me shkronja të shtypit të lexueshme mirë.

2 Nënshkruani kartelën dhe vendosni datën aktuale në të.

3 Vendosni nëse dëshironi të lejoni, të lejoni pjesërisht ose të refuzoni heqjen e organeve, indeve ose qelizave në rast të vdekjes suaj. Ju gjithashtu mund t'ia mbartni këtë vendim një personi të besimit. E rëndësishme: Shënoni me kryq vetëm një nga këto katër mundësitë!

4 Informoni të afërmit tuaj lidhur me vullnetin tuaj.

5 Mbani gjithmonë me vete kartelën e plotësuar të dhurimit (p.sh. në portofolin tuaj).

6 Nëse e ndryshoni opinionin tuaj, thjesht zhdukeni kartelën e vjetër, plotësoni një kartelë të re dhe njoftoni të afërmit tuaj për vendimin tuaj.



TË RËNDËSISHME RRETH KARTELËS SË DHURIMIT

→ Në kartelën e bashkangjitur të dhurimit ju mund të protokoloni, nëse ju dëshironi ose jo të dhuroni pas vdekjes. Ju mund të kufizoni dhurimin në organe, inde ose qeliza të veçanta.

→ Pa masa mjekësore parapërgatitore nuk është i mundur një transplantim i suksesshëm. Prandaj, kartela e dhurimit është krijuar në atë mënyrë që ju me një «Po» të jepni pëlqimin si për marrjen, ashtu edhe për masat përgatitore (shih kapitullin «Masat mjekësore parapërgatitore»).

→ Duhet të merret një miratim i veçantë për marrjen e indeve dhe qelizave, nëse nga ato do të prodhohen produkte, të cilat dalin në treg, për shembull, si zëvendësues për kocka të dëmtuara.

→ Të gjithë personat, të cilët kanë mbushur moshën 16 vjeçe, mund të plotësojnë një kartelë dhurimi. Nëse merret në konsideratë një dhurim për një person më të ri, atëherë vendosin për këtë përfaqësuesit i tij ligjorë.

→ Nëse kartela e dhurimit humbet ose nuk gjendet, atëherë do të pyeten të afërmit më të afërt, nëse ata e njohin vullnetin e personit të prekur. Nëse jo, duhet të vendosin të afërmit dhe gjatë kësaj të marrin parasysh vullnetin e supozuar të personit të prekur. Prandaj, flisni gjithmonë me të afërmit tuaj për vullnetin tuaj.

→ Të dhënat në kartelën e dhurimit nuk regjistrohen asgjëkund. Prandaj, mbajeni kartelën gjithmonë me vete.

→ Nëse ju ndryshoni vendimin tuaj, zhdukeni kartelën e vjetër të dhurimit, plotësoni një të re dhe informoni të afërmit tuaj ose personin tuaj të besimit mbi këtë.

→ Kartela të dhurimit nga jashtë vendit, versionet e mëparshme të kartelës zvicerane të dhurimit ose një shënim i thjeshtë i shkruar me dorë konsiderohen të vlefshme nëse ato, krahas shprehjes së qartë të vullnetit, përmbajnë sa vijon: Emrin, mbiemrin, datën e lindjes, datën dhe nënshkrimin.

→ Në rast të udhëtimeve jashtë vendit, vlejné rregulloret ligjore vendase në lidhje me dhurimin e organeve, indeve dhe qelizave. Informohuni në kohë përpara udhëtimit.



Kartela falas të dhurimit në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht ju mund t'i porositni online: www.leben-ist-teilen.ch. Kartela është gjithashtu në gjuhët kombëtare dhe në gjuhë të tjera të ndryshme e disponueshme për shkarkim si PDF. Përveç kësaj, mund të porositet me telefon kartela e dhurimit në gjermanisht, frëngjisht ose italisht nën numrin 058 123 80 00 ose me e-mail nën: info@swisstransplant.org



Telefoni Telefon

Adresa Adresse

Emri dhe mbiemri i personit të besuar Vor- und Nachname der Vertrauensperson

Une ia vendimin PERSONIT TË BESUAR:
Ich überlasse den Entscheid folgender VERTRAUENSPERSON:

Une them JO për marrjen e organeve, indeve apo qelizave.
Ich sage NEIN zur Entnahme von Organen, Geweben oder Zellen.

Valvulat e zemrës dhe enët e gjakut
Herzkappen und Blutgefässe

Valvulat e zemrës dhe enët e gjakut
Augenhornhaut (Cornea)

Pankreasi
Bauchspeicheldrüse (Pankreas)

Kora
Nieren

Zemra
Herz

Mushkërtë
Lungen

Veshkat
Leber

Zorra e hollë
Dünndarm

Une them PO për marrjen e organeve, indeve apo qelizave dhe për masat
Ich sage JA zur Entnahme folgender Organe, Gewebe oder Zellen und
përgatitore mjekësore lidhur me to:
zu den damit verbundenen vorbereitenden medizinischen Massnahmen.

Une them PO për marrjen e organeve, indeve apo qelizave dhe për masat
Ich sage JA zur Entnahme jeglicher Organe, Gewebe oder Zellen und
përgatitore mjekësore lidhur me to.
zu den damit verbundenen vorbereitenden medizinischen Massnahmen.

Data/Emri i datës Datum/Unterschrift

Emri dhe mbiemri Vor- und Nachname

Une shpreh vullnetin tim në rast se pas vdekjes sime do të merrej
në konsideratë marrja e organeve, indeve apo qelizave:
Ich äusserere meinen Willen für den Fall, dass nach meinem Tod eine
Entnahme von Organen, Geweben oder Zellen infrage kommt:

Hinweis:

Tejlen Sie Ihren Willen betreffend Entnahme von Organen, Geweben
oder Zellen Ihren Angehörigen mit.
Grundlage für die in dieser Karte enthaltene Willensäußerung sind
die Artikel 8 und 10 des Transplantationsgesetzes.
Weitere Informationen finden Sie im Internetportal des Bundes-
amtes für Gesundheit BAG unter www.leben-ist-teilen.ch oder unter
www.swisstransplant.org.

Shënim:

Ndajeni me të afërmit tuaj vullnetin tuaj për marrjen e organeve,
indeve apo qelizave.
Baza ligjore për shprehjen e vullnetit në këtë kartë janë nënë 8
dhe 10 të ligjit për transplantet.
Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të Zyres
Federale të Shëndetit Publik në adresën www.leben-ist-teilen.ch
ose www.swisstransplant.org.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Eidgenössisches Departement des Innern EDI
Bundesamt für Gesundheit BAG



Kartë për dhurimin e organeve Organspende-Karte



Shprehje vullneti pro ose kundër marrjes
së organeve, indeve apo qelizave për qëllim
transplanti
Willensäußerung für oder gegen die
Entnahme von Organen, Geweben oder
Zellen zum Zweck der Transplantation



**Une shpreh vullnetin tim në rast se pas vdekjes sime do të merrej
në konsideratë marrja e organeve, indeve apo qelizave.**

**Entnahme von Organen, Geweben oder Zellen im Falle eines
Ich äusserere meinen Willen für den Fall, dass nach meinem Tod eine
Entnahme von Organen, Geweben oder Zellen im Falle meiner
Eintritt**

Emri dhe mbiemri Vor- und Nachname

Data/ndashkrimi Datum/Unterschrift

Une them **PO** për marrjen e organeve, indeve apo qelizave dhe për masat
përgatitore mjekësore lidhur me to.

Ich sage **Ja** zur Entnahme jeglicher Organe, Gewebe oder Zellen und
zu den damit verbundenen vorbereitenden medizinischen Massnahmen.

Une them **PO** për marrjen e organeve, indeve apo qelizave dhe për masat
përgatitore mjekësore lidhur me to:

Ich sage **Ja** zur Entnahme folgender Organe, Gewebe oder Zellen und
zu den damit verbundenen vorbereitenden medizinischen Massnahmen:

Zorra e hollë Mushkërtë Mëgja Veshkat Zorra e hollë
Dünndarm Nieren Leber Herz Lungen

Pankreasi Koria Veshkat Zorra e hollë
Bauchspeicheldrüse (Pankreas) Augenhornhaut (Cornea)

Valvulat e zemrës dhe enët e gjakut Inde ose qeliza të tjera
Herzklappen und Blutgefässe

Une them **JO** për marrjen e organeve, indeve apo qelizave.
Ich sage **NEIN** zur Entnahme von Organen, Geweben oder Zellen.

Une ia vendimin **PERSONITË BESUARË**
oder Ich überlasse den Entscheid folgender VERTRAUENSPERSON
ose **www.swisstransplant.org**

Adresa Adresse

Telefoni Telefon

**Kartë për dhurimin e organeve
Organspende-Karte**

DHURIMI I ORGANEVE
LEBEN-IST-TEILEN.CH

Shprehje vullneti pro ose kundër marrjes së organeve, indeve apo qelizave për qëllim transplantimi
Willensäußerung für oder gegen die Entnahme von Organen, Geweben oder Zellen zum Zweck der Transplantation

Hinweis:
Teilen Sie Ihren Willen betreffend Entnahme von Organen, Geweben oder Zellen Ihren Angehörigen mit.
Grundlage für die in dieser Karte enthaltene Willensäußerung sind die Artikel 8 und 10 des Transplantationsgesetzes.
Weitere Informationen finden Sie im Internetportal des Bundesamtes für Gesundheit BAG unter www.leben-ist-teilen.ch oder unter www.swisstransplant.org.

Shënim:
Ndajeni me të afërmit tuaj vullnetin tuaj për marrjen e organeve, indeve apo qelizave.
Baza ligjore për shprehjen e vullnetit në këtë kartë janë nënë 8 dhe 10 të ligjit për transplantim.
Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të Zyres Federale të Shëndetit Publik në adresën www.leben-ist-teilen.ch ose www.swisstransplant.org.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Eidgenössisches Departement des Innern EDI
Bundesamt für Gesundheit BAG